



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



ЕВРОТИНК



ЦЕНТАР ЗА  
ЕВРОПСКИ СТРАТЕГИИ



CENTER FOR  
EUROPEAN STRATEGIES

EUROTHINK

eurothink.mk



DOKUMENT I POLITIKAVE PUBLIKE

***“INKLUZIVITET NË VENDIMMARJEN E  
PUNËS SË POLICISË NË REPUBLIKËN  
E MAQEDONISE SË VERIUT”***

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351.74:061.2(497.7)(047.31)  
351.74/.75:316.654(497.7)(047.31)

**STOJANOVSKI, Aleksandar**

Inkluzivitet në vendimmarjen e punës së policisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut [Електронски извор] : dokument i politikave publike / [autorë Aleksandar Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikolovski ; përkthimi maqedonisht - shqip Behar Rushit]. - Shkup : Qendra për strategji evropiane Eurothink, 2022

Начин на пристапување (URL):

<https://eurothink.mk/wp-content/uploads/2022/06/dokument-i-politikave-publike-inkluzivitet-ne-vendimmarjen-e-punes-se-policise-ne-republiken-e-maqedonise-se-ve-riut.pdf>.

- Превод на делото: Инклузивност во носење на одлуки во работата на полицијата во Република Северна Македонија : документ за јавни политики.  
- Текст во PDF формат, содржи 25 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 22.06.2022. - Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамки на проектот: Towards a transparent, accountable and inclusive policing in the Republic of North Macedonia

ISBN 978-608-4923-55-8

1. **Angelevska, Kristina** [автор] 2. **Nikolovski, Dimitar** [автор]  
а) Полиција -- Соработка -- Граѓанско општество -- Македонија -- Истражувања б) Полиција -- Работа -- Јавно мислење -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 57668357

**Botues:**  
EUROTHINK - Qendra e Strategjive Europiane – Shkup

**Rreth botuesit (Redaktues):**  
Dimitar Nikollovski, drejtor ekzekutiv


**Autorë:**  
Aleksandar Stojanovski, Kristina Angelevska, Dimitar Nikollovski

**Rregullimi grafik:**  
Sashka Deskoska

**Përkthimi Maqedonisht - Shqip:**  
Behar Rushit

**Titulli i origjinalit:**  
Документ за јавни политики  
„ИНКЛУЗИВНОСТ ВО НОСЕЊЕ НА ОДЛУКИ ВО РАБОТАТА НА  
ПОЛИЦИЈАТА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА“

Viti 2022



*Botimi është përgatitur në kuadër të projektit “**Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut**”, i zbatuar nga EUROTHINK – Qendra e Strategjive Europiane dhe i mbështetur financiarisht nga National Endowment for Democracy of the United States of America.*

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose të partnerëve të saj.*

# PËRMBAJTJA

01

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

05

02

SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET  
HULUMTUESE TË PROJEKTIT

06

03

REKOMANDIMET

07

04

GJITHËPËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJE NË  
LIDHJE ME PUNËN POLICORE

10

05

MEKANIZMAT PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET  
POLICISË DHE QYTETARËVE

12

06

ANALIZA HULUMTUESE: INKLUZIVITET NË  
VENDIMMARRJEN E PUNËS SË POLICISË NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONISE SË VERIUT

16

07

PËRFUNDIMET

24



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut” zbatohet me qëllim që të kontribuojë në punën më të mirë të policisë dhe rritjen e besimit në policinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky synim i projektit synohet të arrihet duke vlerësuar shkallën e llogaridhënies, transparencës dhe nivelin e vendimmarrjes gjithëpërfshirëse në punën e policisë në nivel kombëtar.

Për më tepër, qëllimi përfundimtar i kësaj sipërmarrjeje njëvjeçare është nxitja e dialogut ndërmjet policisë, medieve dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal, me shpresë se do të kontribuojë në debatin publik për siguri më të madhe në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut.

# SHËNIM METODOLOGJIK MBI AKTIVITETET HULUMTUESE TË PROJEKTIT

## Matja e opinionit publik

Anketa telefonike e kryer në periudhën nga 23 deri më 30 nëntor të vitit 2021 nga BRIMA, në një mostër përfaqësuese prej 1001 të anketuarish, me gabim të vogël +-3%, nëpërmjet metodës CATI.

## Diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

Në periudhën nga dhjetori 2021 deri në mars 2022 janë zhvilluar tetë diskutime në grupet e fokusit me 49 qytetarë, nga të cilët 28 ishin femra dhe 21 meshkuj. Grupet e fokusit janë bërë në qytetet: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Strugë, Manastir, Shtip, Strumicë dhe Veles.

## Intervistat me nëpunësit policorë

Në periudhën nga nëntori 2021 deri në mars 2022 janë kryer 33 intervista me nëpunës policorë nga të tetë sektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## Kërkesat për qasje në informacionet me karakter publik

Në periudhën dhjetor 2021 deri në prill 2022, 92 kërkesa për qasje në informacionet me karakter publik janë dërguar në 84 institucione publike qendrore dhe lokale (të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, MPB, Avokati i Popullit, Prokuroria Publike e Ndjekjes së Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit).

## 01 Rekomandime Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- Të kthehet shërbimi patrullues dhe policia rajonale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përshtatura me kohën e re. Mjetet kërkimore të zbatuara në kuadër të këtij projekti tregojnë se patrulluesit dhe nëpunësit policorë rajonalë kanë dhënë sinergji midis qytetarëve dhe policisë. Me ripërtëritjen e kësaj metode të punës, policia do të jetë dukshëm më afër qytetarëve dhe do të forcojë besimin e ndërsjellë, i cili është i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të punës policore demokratike në shoqëri.
- Të promovojë punën policore parandaluese duke promovuar kompetencat e njësisë organizative për parandalim.
- Të sigurohen fonde më të mëdha në buxhetin e MPB-së për aktivitete dhe programe parandaluese, të cilat do të jenë transparente dhe të dukshme për palët e interesuara.
- Të përmirësohet kuadri arsimor për nëpunësit policorë, në drejtim të punës policore parandaluese dhe shkathtësive dhe parimeve për komunikimin me qytetarët.
- Të investohet më shumë në mjetet materiale dhe teknike të nevojshme për punën parandaluese të policisë, të cilat do të jenë të matshme (të sakta);
- Të përforcohet promovimi i konceptit “policia në bashkësi” dhe të informohet vazhdimisht publiku për zbatueshmërinë e tij në bashkësitë lokale. Të përforcohet funksionaliteti i këshillave lokale të parandalimit (KLP) aty ku janë ngritur.
- Të inkurajohet përfshirja aktive e nëpunësve policorë gjatë takimeve me grupet këshillëdhënëse të qytetarëve, në mënyrë që ata të njihen më mirë me problemet e qytetarëve në fushën e cilësisë së jetës, gjë që do të mundësohet një qasje e përbashkët për promovimin dhe forcimin e konceptit “policia në bashkësi” dhe “policia pranë qytetarëve”.

## 02 Rekomandime për njësitë e vetëqeverisjes lokale:

- Të formohen këshillat lokale të parandalimit (KLP) aty ku nuk janë themeluar (në së paku 13 komuna nuk është themeluar KLP).
- Në ato komuna ku KLP-të janë themeluar por nuk kanë pasur asnjë seancë, është e rëndësishme që ato të aktivizohen. Pothuajse një e katërta e njësive të vetëqeverisjes lokale në vend kanë themeluar KLP, por nuk kanë kryer asnjë aktivitet. KLP-të e krijuara por jo aktive janë mekanizma jo efektiv dhe të papërdorur për bashkëpunim ndërmjet institucioneve përkatëse.
- Të bëhet transparente puna e KLP-ve dhe të informohet në mënyrë të rregullt publiku për diskutimet dhe rezultatet e punës së këtyre mekanizmave. Të definohet detyrimi për informimin e rregullt të publikut për përbërjen, punën dhe rezultatet e KLP-ve.
- Të parashihen mjete për programe dhe projekte me buxhetet vjetore të komunave të tyre, të cilat do të ndihmojnë punën parandaluese dhe edukative të policisë dhe institucioneve të tjera përkatëse.
- Të parashihet detyrë për mediet lokale, të cilat do të ishin pjesë/partnerë me KLP-të.

## 03 Rekomandime për pushtetin qendror dhe për Bashkësinë e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL):

- Të vendoset një kornizë ligjore për konstituimin dhe funksionimin e detyrueshëm të këshillave lokale të parandalimit, me qëllim që të mundësohet funksionaliteti i qëndrueshëm i tyre. Kjo do të mundësojë konsolidimin e mekanizmave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe prioritete në punën e policisë në bashkësi. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e konsiderueshëm të mekanizmave demokratikë brenda qeverisjes lokale dhe do të mundësojë njohjen aktive të qytetarëve me konceptin “policia në bashkësi” dhe përfshirjen e të gjitha institucioneve në nivel lokal për të adresuar reciprokisht sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët.
- BNJVL-ja të vendosë themelimin e KLP-ve si prioritet në komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



## 04 Rekomandime për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile:

- Për të arritur një funksionim të suksesshëm dhe efektiv të konceptit “policia në bashkësi”, është e nevojshme që në mënyrë proaktive të angazhohen organizatat e shoqërisë civile dhe OJQ-të për organizimin dhe zbatimin e rregullt të forumeve të hapura për diskutime me qytetarët, e cila do të shërbejë si urë lidhëse mes qytetarëve dhe policisë, për të forcuar komunikimin mes policisë dhe qytetarëve. Në këtë mënyrë do të forcohet 'besimi i qytetarëve te policia dhe do të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e konceptit “policia në bashkësi”. Njëkohësisht do të rritet edhe afërsia me policinë për të arritur efikasitet në polici.
- Të inicohet dhe të ndihmohet në formimin e grupeve këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ), të cilat janë mekanizëm i unitetit ndërmjet policisë dhe qytetarëve, përmes të cilave do të krijohen kushte pozitive për zhvillimin e besimit ndërmjet policisë, qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Kjo do të mundësojë promovimin më efektiv të konceptit “policia në bashkësi”, por edhe artikullimin e nevojave dhe pritshmërive të bashkësisë për çështje që lidhen me sigurinë dhe rendin publik.

## 05 Rekomandime për mediet dhe punonjësit mediatikë:

- Mediet dhe punonjësit e medias të vazhdojnë me zell dhe në mënyrë aktive të monitorojnë aktivitetet e policisë, veçanërisht aktivitetet e kryera nga Ministria e Punëve të Brendshme në promovimin e punës policore demokratike përmes konceptit “policia në bashkësi”. Kështu, qytetarët do të informohen për këtë mënyrë të punës së policisë, e cila mundëson afirmimin dhe forcimin e besimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve.
- Të inkurajohet vendosja e bashkëpunimit të ndërsjellë me administratat komunale dhe mediet, në mënyrë që punonjësit e medie të mund ta ndjekin rregullisht punën e këshillave lokale të parandalimit (KLP), të marrin pjesë në seancat e KLP-ve dhe në diskutimet me grupet këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ) dhe në forumet për diskutime të hapura. Kjo do të forcojë ndjeshëm konceptin “policia në bashkësi” dhe publiku do të informohet rregullisht për aktivitetet e vazhdueshme të këshillave lokale parandaluese, grupeve këshillëdhënëse të qytetarëve dhe forumeve për diskutime të hapura.

# GJITHËPËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJE NË LIDHJE ME PUNËN POLICORE

Policia është manifestimi më i dukshëm i qeverisë në një vend, roli social i të cilit është të garantojë sigurinë publike.<sup>1</sup> Krimi është mbi të gjitha problem në bashkësi dhe si i tillë nuk është vetëm problem i policisë. Prandaj, zgjidhja e krimit qëndron në parandalimin e tij, por edhe në parandalimin e kushteve që mundësojnë dhe e stimulojnë sjelljen kriminale. Qëllimi përfundimtar i parandalimit të krimit dhe i punës policore parandaluese është përmirësimi i cilësisë së jetës për bashkësinë. Pa bashkëpunim me individë dhe grupe që janë pjesë e bashkësisë, puna policore në shoqëritë demokratike do të ishte pothuajse e pamundur. E thënë thjesht, policia do të humbiste rolin e saj pa mbështetjen aktive të bashkësisë për të cilin punon.

Ministria e Punëve të Brendshme, nëpërmjet Sektorit të punëve të brendshme, është padyshim një nga faktorët më të rëndësishëm përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e konceptit të punës policore në bashkësi.<sup>2</sup> Përvojat dhe praktikat e shoqërive demokratike tregojnë se përfshirja efektive e bashkësisë, prania fizike e policëve rajonale dhe patrullave të rregullta në terren, së bashku me zgjidhjen e përbashkët të problemeve, rrisin ndjeshëm besimin e publikut në polici.

Nëpërmjet vendimmarrjes gjithëpërfshirëse dhe ndërveprimit pozitiv me bashkësinë, policia mund të arrijë një perceptim të përmirësuar publik për punën e tyre. Kjo lloj qasjeje do të çojë në mënyrë të pashmangshme në rritjen e besimit dhe legjitimitetit të shtuar të policisë. Duke vepruar kështu, është thelbësore të kuptohet se për fitimin e mbështetjes publike dhe të besimit në policinë, është e nevojshme pajtueshmëria nga shoqëria dhe nga qytetarët. Prandaj, një element i rëndësishëm i punës policore demokratike është vendosja e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me qytetarët.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Doracak i punës policore demokratike nga këshilltari i Lartë i Policisë së sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së [Прирачник за демократско полициско работење од вишиот полициски советник на генералниот секретар на ОБСЕ], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 7, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>.

<sup>2</sup> Selimi, Bogdanovski, "Puna policore në bashkësi - nga ideja në realitet" [Полициско работење во заедницата – од идеја до реалност], raport - Analytica, Shkup, 2015, f. 13, [https://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika\\_Web\\_Mk\\_06549.pdf](https://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika_Web_Mk_06549.pdf).

<sup>3</sup> Doracak i punës policore demokratike nga Këshilltari i Lartë i Policisë së Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së [Прирачник за демократско полициско работење од вишиот полициски советник на генералниот секретар на ОБСЕ], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 13, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>.

Një nga parakushtet më të rëndësishme për një punë policore efektive është besimi i publikut tek policia. Pa besimin tek policia si shërbim publik, qytetarët nuk do të motivoheshin, gjegjësisht inkurajoheshin që të kontribuonin në mënyrë aktive në luftimin e formave të reja të krimit. Prej këtu rrjedh edhe thelbi i punës policore në bashkësi, pra koncepti “policia në bashkësi”, i cili në fakt është një nevojë për të vendosur një ndryshim në qasjen e komunikimit të policisë me qytetarët.<sup>4</sup>

Puna policore në bashkësi duhet të bazohet në orientimin drejt nevojave të qytetarëve, si dhe të mundësohet pjesëmarrje më e madhe e publikut dhe e qytetarëve në vendimmarrje, e cila do të sigurojë kujdes më të madh për sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët çdo ditë dhe në atë mënyrë, do të mund të forcohet besimi te policia.

Titulli i këtij dokumenti, si dhe komponenti i gjithëpërfshirjes, që është pjesë e projektit, i referohen dëgjimit të policisë për nevojat dhe problemet e grupeve dhe individëve në një bashkësi, pra shkallës së gatishmërisë dhe nivelit të përfshirjes në një marrëdhënie dinamike ndërmjet policisë dhe bashkësisë.

Strategjia e MPB-së për përfshirjen dhe komunikimin me bashkësinë (PKB) për periudhën 2020-2022 është një përpjekje për t'i ngritur në një nivel më të lartë strategjik projektet dhe praktikat ekzistuese për bashkëpunimin e policisë me qytetarët. Që nga miratimi i Strategjisë së parandalimit në vitin 2008, janë krijuar një sërë praktikash pozitive që janë të dobishme për punën e ardhshme të policisë me bashkësinë si një hap drejt së ardhmes. Rishikimi i këtyre praktikave tregon se ato duhet të ndryshojnë për shkak të ndryshimit të natyrës së bashkësive dhe ndryshimit të karakteristikave të krimit, dhunës dhe parregullsisë. Vlerësimi i këtyre arritjeve, duke përfshirë vështirësitë dhe kufizimet e vlerësuara në zbatimin e tyre, është një pikënisje e rëndësishme në identifikimin e nevojave dhe mundësive reale për përcaktimin e prioriteteve të arritshme në këtë fushë. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të theksohet se Ministria e Punëve të Brendshme, si organ shtetëror, është në proces të reformimit të sistemit të sigurisë, si dhe të administratës së përgjithshme shtetërore.<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup> Doracak i bazave të punës parandaluese policore [Прирачник: Основи на превентивно полициско работење], Shkup, 2013, f. 12–14, <http://arhiva.mvr.gov.mk/images/%D0%9E%D1%81%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B2%D0%BD%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%20%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%9A%D0%B5.pdf>

<sup>5</sup> Strategjia e përfshirjes dhe e komunikimit me bashkësinë 2020–2022 e Ministrisë së Punëve të Brendshme [Стратегија за вклучување и комуникација со заедницата 2020–2022 на Министерство за внатрешни работи], dhjetor, 2019 f. 7 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/strategji/CEC%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/strategji/CEC%20STRATEGY_MK.pdf)

# MEKANIZMAT PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET POLICISË DHE QYTETARËVE

Krijimi i mekanizmave për bashkëpunim ndërmjet policisë dhe qytetarëve është një strategji organizative që promovon bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet qytetarëve dhe policisë. Policia dhe qytetarët do të bashkëpunojnë për identifikimin dhe prioritizimin e problemeve në shoqëri si krimi, shqetësimet sociale dhe fizike në bashkësinë lokale, të gjitha për të kontribuar në një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së jetës në një zonë të caktuar.<sup>6</sup> Pikërisht për këtë, komponentët kyç për një partneritet dhe komunikim të suksesshëm ndërmjet policisë dhe qytetarëve janë: forumet për diskutime të hapura, gjegjësisht grupet këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ), këshillat lokale të parandalimit (KLP) në korniza të njësive vetëqeverisëse lokale dhe njësitë/ segmentet (OE) e parandalimit të policisë.

## 01 Forumet për diskutim të hapur dhe grupet këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ)

Programet ndërvepruese për afrim në bashkësi, të tilla si forumet formale dhe joformale për diskutim të hapur ndërmjet policisë dhe qytetarëve dhe përfaqësuesve nga të gjitha bashkësitë, janë shumë të rëndësishme të mundet policia më të mirë që të njihet me opinionin e qytetarëve, si dhe për të mundësuar krijimin e mundësive për bashkëpunim. Vizioni për krijimin e forumeve të tilla për diskutime të hapura buron nga koncepti i punës policore në bashkësi, qëllimi kryesor i të cilit është të inkurajojë bashkëpunimin midis policisë dhe qytetarëve për të identifikuar dhe adresuar shqetësimet e qytetarëve për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës.<sup>7</sup>

Koncepti i grupeve këshillëdhënëse të qytetarëve në Maqedoni u prezantua në maj të vitit 2002 në një konferencë për punën policore në bashkësi, të organizuar nga Njësia e zhvillimit të policisë e OSBE-së. Në shoqëritë demokratike, grupet këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ) shpesh përdoren si mjet për të ofruar këshilla të vazhdueshme për Këshillin Komunal, KLP-të dhe administratat komunale për një sërë çështjesh me interes të përbashkët për popullatën lokale.

<sup>6</sup> Doracak i punës policore demokratike nga këshilltari i Lartë i Policisë së sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së [Прирачник за демократско полициско работење од вишиот полициски советник на генералниот секретар на ОБСЕ], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 7, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>.

<sup>7</sup> Doracak i punës policore demokratike nga këshilltari i Lartë i Policisë së sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së [Прирачник за демократско полициско работење од вишиот полициски советник на генералниот секретар на ОБСЕ], Vjenë, maj 2008, edicioni i dytë, f. 37, <https://www.osce.org/files/f/documents/f/f/109907.pdf>.

GKQ-ja është një formë bashkëpunimi dhe qasje e përbashkët, përmes së cilës qytetarëve dhe policisë u mundësohet të punojnë së bashku për të gjetur zgjidhje. Mbi bazën e linjave të hapura të komunikimit ndërtohet dhe përmirësohet besimi dhe vendosen marrëdhënie pozitive mes dy palëve.<sup>8</sup> Në këtë mënyrë, avantazhet dhe aspektet pozitive të aplikimit të diskutimeve në kuadër të GKQ-së përmirësojnë dukshëm komunikimin e policisë me qytetarët dhe në këtë mënyrë mundësojnë përmirësimin e punës së policisë.<sup>9</sup>

Nëpërmjet një qasjeje të gjerë të partneritetit dhe përfaqësimit të policisë dhe qytetarëve në bashkësi, përcaktohen nevojat e bashkësisë dhe prioritetet e policisë, gjë që inkurajon përgjegjshmërinë, transparencën dhe efektivitetin e policisë në qasjen gjithëpërfshirëse të vendimmarrjes.

## 02 Këshillat lokale të parandalimit (KLP)

KLP-ja është një organ për veprim të përbashkët të palëve të interesuara dhe aktorëve përkatës në fushën e sigurisë publike në nivel lokal, si dhe për zbatim të suksesshëm të konceptit “policia në bashkësi”. Baza për formimin e tyre gjendet në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligjin e Policisë.<sup>10</sup> Më konkretisht, neni 11 i Ligjit të Policisë<sup>11</sup> parasheh bashkëpunimin e policisë me qytetarët, organet shtetërore dhe shoqatat e qytetarëve. Për të krijuar bashkëpunim dhe për të mundësuar forcimin e ndikimit të publikut në punën e policisë (paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni), mund të krijohen organe këshillëdhënëse dhe koordinuese (këshilla dhe komisione), me qëllim që të ndërtohen rekomandime të përbashkëta dhe të vendosen partneritete ndërmjet qytetarëve dhe policisë, për përmirësimin e sigurisë publike në territorin e një komune të caktuar dhe për parandalimin e suksesshëm të dukurive që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve dhe të bashkësisë.

<sup>8</sup> Doracak: "Bazat e punës parandaluese policore" [Прирачник: „Основи на превентивно полициско работење], Seksioni i parandalimit dhe SPKP - SPB Shkup, 2013 f. 20 <http://arhiva.mvr.gov.mk/images/%D0%9E%D1%81%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B2%D0%BD%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%20%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%9A%D0%B5.pdf>.

<sup>9</sup> Kosma, Jovanova, “Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal” [Учество на граѓани во носење на одлуки на локално ниво], Shkup, 2013 f. 3-6, <https://www.osce.org/files/f/documents/5/3/231366.pdf>.

<sup>10</sup> Këshilli Lokal i Parandalimit [Локален совет за превенција], Shkup, 2018 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20(1).pdf).

<sup>11</sup> Ligji i Policisë [Закон за полиција], Shkup, 2015 f. 4, <https://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf>.

Pikërisht për këtë KLP-ja si mekanizëm i bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve duhet të kontribuojë dukshëm në ndërtimin e besimit të qytetarëve në polici, si dhe në forcimin e partneritetit ndërmjet institucioneve shtetërore, vetëqeverisjes lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Në të njëjtën kohë, ky trup, për veprimtari të përbashkët në bashkësitë lokale, është në thelb, një mjet për partneritet me bashkësinë për ruajtjen e sigurisë publike, ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit në parandalimin e problemeve të sigurisë, si dhe organizimin e formave të tjera të përfshirjes së qytetarëve në identifikimin e problemet lokale dhe zhvillimin e mënyrave të zbatueshme për zgjidhjen e tyre.<sup>12</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se në praktikë KLP-të nuk janë të rregulluara në legjislacionin kombëtar. Neni 25 i Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale nuk parasheh obligim ligjor për themelimin e detyrueshëm të këshillave lokale të parandalimit, andaj edhe përkundër mungesës së detyrimit ligjor për themelimin e KLP-ve, padyshim është e rëndësishme që pushteti lokal ato t'i njeh si mjet thelbësor për zhvillimin e qasjes gjithëpërfshirëse për ndërtimin e një mjedisi të sigurt jetese.<sup>13</sup>

Pas konfliktit ushtarak të vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut, nevoja për themelimin e një Këshilli Lokal të Parandalimit (KLP), me qëllim të përfshirjes aktive të palëve relevante të interesit në procesin e ballafaqimit të sfidave dhe problemet me të cilat përballen qytetarët në bashkësitë lokale, për të mundësuar një mënyrë jetese më të mirë.<sup>14</sup>

Ideja e krijimit të këshillave lokale të parandalimit buron nga përfshirja e OSBE-së në programin e punës policore në bashkësi në Maqedoni, në mënyrë që të ofrohet mbështetje më e gjerë institucionale dhe qytetare për modelin e punës policore në bashkësi.<sup>15</sup>

<sup>12</sup> Strategjia e përfshirjes dhe e komunikimit me bashkësinë 2020–2022 e Ministrisë së Punëve të Brendshme [Strategjia za vkluchuvanje i komunikacija so zaednicata 2020–2022 na Ministerstvomto za vnatreshni raboti], dhjetor, 2019 f. 7 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/strategii/CEC%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/strategii/CEC%20STRATEGY_MK.pdf).

<sup>13</sup> Këshilli Lokal i Parandalimit [Локален совет за превенција], Shkup, 2018, f. 8 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20(1).pdf).

<sup>14</sup> OSCE Polis Digital Library, “Local Prevention Council”, <https://polis.osce.org/node/3556>.

<sup>15</sup> Selimi, Bogdanovski, “Puna policore në bashkësi - nga ideja në realitet” [Полициско работење во заедницата \ – од идеја до реалност], raport - Analytica, Shkup, 2015, f. 17, [https://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika\\_Web\\_Mk\\_06549.pdf](https://www.analyticamk.org/images/news/2015/11/Analitika_Web_Mk_06549.pdf) Accessed 27 Apr. 2022.

Prandaj, këshilli lokal i parandalimit është një nga mjetet më të njohura për zhvillimin dhe ndërtimin e konceptit “puna policore” në bashkësi, veçanërisht brenda vetëqeverisjes lokale. Parandalimi si stil i punës policore zbatohet përmes njësive organizative të parandalimit dhe ka të bëjë me ndërtimin e një marrëdhënieje pozitive me bashkësinë, zhvillimin e programeve parandaluese, identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe propozimin e masave dhe aktiviteteve për të reduktuar ndikimin e tyre.<sup>16</sup>

Koncepti “policia në bashkësi” për komunikim dhe bashkëpunim të ndërsjellë me qytetarët është i rregulluar në Ligjin e Policisë dhe Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, si dhe me mekanizmat për orientimin e punës së policisë drejt nevojave të qytetarëve, siç janë forumet për diskutime të hapura dhe këshillat lokale për parandalim. Megjithatë, përkundër vendosjes institucionale të punës së policisë, analizat nga hulumtimi në terren, si pjesë integrale e projektit “Drejt policisë transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, tregojnë se parimi i gjithëpërfshirjes në vendimmarrje dhe përfshirja aktive e qytetarëve në polici duhet të forcohet më tej për të mundur një marrëdhënie bashkëpunuese dhe produktive ndërmjet policisë dhe qytetarëve.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> Këshilli Lokal i Parandalimit [Локален совет за превенција], Shkup, 2018, f. 8 [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Local-Prevention-Council-Final%20(1).pdf).

<sup>17</sup> Doracak: "Bazat e punës parandaluese policore" [Прирачник: Основи на превентивно полициско работење], Seksioni i parandalimit dhe SPKP - SPB Shkup, 2013 f. 18 <http://arhiva.mvr.gov.mk/images/%D0%9E%D1%81%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B2%D0%BD%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%20%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%9A%D0%B5.pdf>.

# ANALIZA HULUMTUESE: INKLUZIVITET NË VENDIMARJEN E PUNËS SË POLICISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISE SË VERIUT

**Sondazhi i opinionit publik.** “Perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e policisë”, hulumtim i realizuar për nevojat e projektit “Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Sondazhi i opinionit publik është kryer në periudhën nga 23 nëntori i vitit 2021 deri më 30 nëntor të vitit 2021 në një ekzemplar përfaqësues prej 1001 të anketuarish, ku kanë qenë të përfshirë komponentë kyç të konceptit “puna policore në bashkësi”, duke përfshirë: besimin e qytetarëve në institucionet, punën e policisë dhe duke marrë parasysh mendimet dhe nevojat e qytetarëve.

## Fragment nga sondazhi i opinionit publik “Eurometri, dimër 2021”<sup>18</sup>

Qytetarët në momentin e matjes kanë besimin më të madh në: **Ushtrinë e RMV-së (47%)**, në kryetarin e RMV-së (31%), në bashkësitë fetare (30%), si dhe në polici (25%), ndërsa besimin më të vogël e kanë në gjyqësor (8%) dhe në prokurori (8%).

Njëkohësisht, është e rëndësishme të theksohet se në këtë matje të opinionit publik policia fiton më shumë besim në raport me aktorët e tjerë të krimit. sistemi i drejtësisë (gjyqësori) dhe prokuroria mbeten institucionet me vlerësimin më të ulët).

<sup>18</sup> Stojanovski, Aleksandar. “Perceptime dhe qëndrime për punën e policisë së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut” [Перцепции и ставови на граѓаните на Република Северна Македонија за работата на полицијата] – Hulumtim i shqyrtuar për nevojat e projektit “Drejt policisë transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, EUROTHINK, nëntor 2021, <https://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/12/%D0%A2%D1%80%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B8-%D0%BE%D1%82%D1%87%D0%B5%D1%82%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0.pdf>



Kur bëhet fjalë për punën e policisë, përgjithësisht dominon vlerësimi i ulët i të gjitha aspekteve të matjes. Megjithatë, 30% e të anketuarve besojnë se policia është profesionale në punën e saj, 26% besojnë se është efikase, ndërsa 16% besojnë se policia merr parasysh mendimet dhe nevojat e qytetarëve në marrjen e vendimeve për punën e saj.

Nga ana tjetër, përkundër vlerësimin të përgjithshëm të ulët të punës së policisë, qytetarët që kanë pasur kontakte personale me policinë vlerësojnë pozitivisht profesionalizmin e punonjësve të policisë në punën e tyre. Kjo kontradiktë krijon përshtypjen se qëndrimi i përgjithshëm ndaj punës së policisë profilizohet nga faktorë të tjerë, dhe jo si qëndrim i ndërtuar mbi bazën e përvojës personale dhe konkrete nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me nëpunësit policorë.

Për sa i përket temës “policia në bashkësi” si koncept i punës policore dhe i organizimit të punës policore në nivel lokal, vetëm 9% e të gjithë të anketuarve e njohin këtë koncept të punës.

#### **Fragment nga sondazhi i opinionit publik “Eurometri, dimër 2021”<sup>19</sup>**

Është vlerësuar pozitivisht funksionimi i konceptit “puna policore në bashkësi”; megjithatë, vetëm 5.4% e të anketuarve janë të njohur me rolin dhe punën e këshillave lokale të parandalimit (KLP) në komunën e tyre. Kjo e dhënë çon në përfundimin se promovimi/informimi i publikut për konceptin “puna policore në bashkësi”, si dhe puna e KLP-së duhet të forcohet dhe promovohet, pra të fitojë një afirmim shumë më të gjerë.

---

<sup>19</sup> ibid.

## Diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

Gjetjet kryesore nga diskutimet me qytetarët, të zhvilluara në periudhën nga dhjetori i vitit 2021 deri në mars të vitit 2022 tregojnë se parimi i vendimmarrjes gjithëpërfshirëse duhet të të forcohet dhe të promovohet më tej në mesin e qytetarëve dhe policisë.

Gjatë diskutimeve me qytetarët, opinionet dhe pikëpamjet e tyre u mbuluan plotësisht, ku pjesëmarrësit diskutuan dhe analizuan hapur punën e policisë në bashkësitë e tyre lokale, duke u fokusuar veçanërisht në vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, konceptin “puna policoret në bashkësi” dhe efektivitetin e policisë në bashkësitë e tyre. Në përgjithësi, diskutuesit janë të mendimit se policia është pjesërisht e përfshirë në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivel lokal, që në fakt është një nga sfidat kryesore në punën policore në bashkësi - mungesa e një qasjeje gjithëpërfshirëse në vendimmarrje, kryesisht ndërmjet policisë dhe qytetarëve.

### Fragment nga diskutimet e fokus grupeve me qytetarët

“Është shumë e vështirë të flasësh me policinë, ata gjithmonë thonë: Tërhiquni, na lejoni të punojmë” - bashkëbisedues, GF Strugë.

Të pyetur për konceptin “**puna policore në bashkësi**”, gjegjësisht policia pranë qytetarëve, diskutuesit u njohën pjesërisht dhe e konsideruan atë si një strategji të shkëlqyer organizative, por të vështirë për t'u zbatuar sepse komunikimi i policisë me qytetarët është përafërsisht i dobët për shkak se qytetarët dhe publiku nuk janë mjaftueshëm të informuar për zhvillimet aktuale.

### Fragment nga diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

“Nuk e perceptojmë si polici në bashkësi” - bashkëbisedues GF Tetovë.

Nga ana tjetër, disa nga bashkëbiseduesit e përkufizojnë konceptin “**puna policoret në bashkësi**” si “**polici pranë qytetarëve**”, gjegjësisht nëpunës policorë, të cilët nuk janë të uniformuar dhe nga të cilët ia kanë frikë – përkundrazi, ndihen të sigurt pranë tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë të gjitha diskutimeve të zhvilluara në tetë rajonet planore në Maqedoninë e Veriut, diskutuesit theksuan se koncepti i policisë rajonale dhe i shërbimit policor duhet të ripërtërihet, sepse përvoja e qytetarëve në këtë mënyrë të bashkëpunimit të ndërsjellë me policinë u tregua jashtëzakonisht e suksesshme në sistemin e kaluar.

Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit në Kumanovë dhe Shtip<sup>20</sup>, u bisedua edhe për përpjekjet e MPB-së për kthimin e policëve rajonalë në këto qytete, ku bashkëbiseduesit e vlerësuan pozitivisht këtë mekanizëm dhe theksuan se do të ishte me rëndësi nëse MPB-ja bën përpjekje për të rinovuar këtë koncept edhe në qarqe të tjera të vendit.<sup>21</sup>

#### Fragment nga diskutimet e grupeve të fokusit me qytetarët

“Policia në bashkësi nënkupton sinergji ndërmjet policisë dhe qytetarëve – komunikim kreativ mes tyre” – bashkëbisedues, FG Shkup.

## Intervistat me nëpunës policorë

Intervistat e realizuara me nëpunës policorë nga sektorët e punëve të brendshme (SPB) në tetë rajonet planifikuese në Maqedoninë e Veriut në periudhën nga dhjetori i vitit 2021 deri në mars të vitit 2022, i nxori faktorët kryesorë që ndikojnë drejtpërdrejt në punën e policisë, siç janë mangësitë sistematike në punën e policisë, përfshirë mungesën e motivimit të nëpunësve policorë dhe investimet e kufizuara në zhvillimin e tyre profesional, gjë që ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e detyrave. Gjatë bisedimeve, diskutuesit u ndalën në rëndësinë dhe efektivitetin e konceptit “puna policore në bashkësi”, zhvillimin profesional të punonjësve të policisë, si dhe funksionimin e këshillave lokale të parandalimit (KLP).

<sup>20</sup> “Polic i lagjes në territorin e SPB Shtip” [Маалски полицаец на подрачјето на СВР Штип], Ministria e punëve të brendëshme, Lajme, nëntor 2017 vit., <https://mvr.gov.mk/vest/5221>

<sup>21</sup> “Është promovuar shërbimi rojtar policer në Kumanovë” [Промовирана позорничарската служба во Куманово], Sitel, shkurt 2017 vit., <https://sitel.com.mk/promovirana-pozornikarskata-sluzhba-vo-kumanovo>

Sipas tyre, koncepti “**polici në bashkësi**”, pra “**polici pranë qytetarëve**” është një bashkëpunim kyç që një shoqëri të funksionojë normalisht dhe në harmoni. Në përgjithësi, diskutuesit besojnë se, për të vendosur një funksionim normal dhe të suksesshëm të policisë, është e nevojshme të forcohet komunikimi ndërmjet policisë dhe qytetarëve, veçanërisht në bashkësitë lokale, i cili është një mjet kyç për punën policore efektive.

#### **Vlerësimi mesatar nga intervistat e kryera me nëpunësit policorë në 8 (tetë) sektorë të brendshëm**

**“Policia në Maqedoninë e Veriut merr parasysh mendimet dhe nevojat e qytetarëve në marrjen e vendimeve për punën e tyre” - nota mesatare: 3.5.**

(Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është nota më e ulët dhe 5 është nota më e lartë).

Sa i përket funksionimit të këshillave lokale parandaluese, të anketuarit mendojnë se KLP-të duhet të jenë baza e konceptit “policia në bashkësi”, i cili do të përfshijë të gjitha institucionet në nivel lokal për të adresuar reciprokisht sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët. Sipas tyre, KLP-të funksionojnë pjesërisht në bashkësitë lokale dhe në të njëjtën kohë nuk ka kornizë ligjore për t'u aktivizuar dhe për këtë arsye janë vetëm pro-forma në kuadër të komunave.

Po ashtu, nuk është vendosur bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet sektorëve të punëve të brendshme dhe komunave për të mundësuar funksionimin e qetë të KLP-së. Pikërisht për këto rrethana dhe zhvillime, ata mendojnë se duhet të krijohet një kornizë ligjore për vetëqeverisjen lokale, sepse pa të nuk mund të krijohet një praktikë për të aktivizuar mekanizmin “këshilli lokal i parandalimit”. Disa nga diskutuesit theksuan rëndësinë e funksionimit të grupeve këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ), të cilat formalisht ekzistojnë pas themelimit të konceptit “policia në bashkësi” në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por besojnë se takimet me GKQ-të janë iniciuar kryesisht nga sektorët e brendshëm në shtet.

Në përgjithësi, diskutuesit janë të mendimit se nuk mund të ketë dobësi në punën e policisë kur ka bashkëpunim të ndërsjellë me qytetarët.

## Kërkesat për qasje në informatat me karakter publik

Në periudhën dhjetor 2021 - janar 2022 janë dërguar 81 kërkesa për qasje në informata publike të dedikuara për komunat në tetë rajonet planore në Maqedoninë e Veriut. Kërkesave për informim publik në lidhje me themelimin dhe funksionimin e këshillave lokale për parandalim, nga gjithsej 81 komuna, përgjigje kanë dorëzuar 66 komuna, 12 komuna nuk kanë dhënë përgjigje, ndërsa 3 komuna kanë refuzuar të marrin kërkesën për qasje ndaj informatave me karakter publik.

Gjithashtu, gjatë realizimit të dialogut lokal me përfaqësues të administratave komunale, me organizatat joqeveritare, me mediet dhe me përfaqësuesit e drejtorive për punë të brendshme nga Komuna e Kumanovës, Komuna e Velesit, Komuna e Tetovës, Komuna e Shtipit, Komuna e Manastirit, Komuna e Ohrit dhe Komuna e Strumicës, jemi njoftuar se Komuna e Shtipit, Komuna e Kratovës, Komuna e Mavrovës dhe e Rostushës dhe Komuna e Ohrit kanë formuar Këshill Lokal të Parandalimit në periudhën ndërmjet viteve 2017 dhe 2021, megjithëse nuk iu përgjigjën kërkesës për qasje në informacione publike brenda afatit të caktuar.

Është e rëndësishme të theksohet se KLP-të funksionale përfshijnë përfaqësues nga një gamë e gjerë institucionesh: kryetarë komunash, kryetarë të këshillave të komunave, përfaqësues të medieve lokale, OJQ-ve, bashkësive fetare, institucioneve shëndetësore, institucioneve arsimore, institucioneve, si dhe përfaqësues të sektorëve të punëve të brendshme (SPB), stacionet policore (SP), prokuroritë publike dhe gjykatat me juridiksion në territoret e komunave, si dhe ministritë e linjës dhe palët e tjera të interesuara.

Komunat me KLP funksionale	Numri i seancave të KLP-ve funksionale të mbajtura në periudhën 2017-2021	Komunat me KLP jofunksionale	Komunat të cilat ende nuk kanë formuar KLP
Komuna e Haraçinës	2	Komuna e Berovës	Komuna e Vallandovës
Komuna e Manastirit	1	Komuna e Bërvenicës	Komuna e Dibrës
Komuna e Bogdancit	6	Komuna e Vevçanit	Komuna e Zelenikollës
Komuna e Bosillovës	disa seanca	Komuna e Velesit	Komuna e Karbincit
Komuna e Vasilevës	2	Komuna e Gostivarit	Komuna e Koçanit
Komuna e Vinicës	1	Komuna e Gradskos	Komuna e Llozovës
Komuna e Vrapçishtit	2	Komuna e Debarcës	Komuna e Mogillës
Komuna e Gjevgjeliës	3	Komuna e Kërçovës	Komuna e Novosellës
Komuna e Dellçevës	1	Komuna e Krushevës	Komuna e Petrovecit
Komuna e Demir Kapisë	disa seanca	Komuna e Makedonski Brodit	Komuna e Pehçevës
Komuna e Demir Hisarit	1	Komuna e Resnjës	Komuna e Radovishit
Komuna e Dojranit	4	Komuna e Tearcës	Komuna e Sopishtit
Komuna e Zhelinës	10	Komuna e Çashkës	Komuna e Qendrës Zhupë
Komuna e Ilindenit	2	Komuna e Aerodoromit	Komuna e Shtipit
Komuna e Kavadarit	2	Komuna e Butelit	Komuna e Shuto Orizarës
Komuna e Kriva Pallankës	3	Komuna e Gazi Babës	Qyteti i Shkupit
Komuna e Krivogashtanit	1	Komuna e Gjorçe Petrovit	
Komuna e Kumanovës	14	Komuna e Sarajit	
Makedonska Kamenicës	3		
Komuna e Pllasnicës	1		
Komuna e Përlepit	1		
Komuna e Probishtipit	4		
Komuna e Rankovcit	2		
Komuna e Shën Nikollës	3		
Komuna e Strugës	9		
Komuna e Strumicës	4		
Komuna e Studeniçanit	1		
Komuna e Karposhit	3		
Komuna e Sarajit	2		
Komuna e Tetovës	1		
Komuna e Çairit	5		

Tregues tabelor i 15 komunave për të cilët nuk ka informacion për statusin e LPK-së	
Komunat të cilat nuk kanë dhënë përgjigje	Komunat të cilat kanë refuzuar të pranojnë kërkesën për qasje deri tek informacionet me karakter publik
Komuna e Dollnenit	Komuna e Bogovinës
Komuna e Zërnovcit	Komuna e Mavrovës dhe e Radostushës
Komuna e Jegunovcit	Komuna e Nagoriçit të Vjetër
Komuna e Konçës	
Komuna e Kratovës	
Komuna e Likovës	
Komuna e Negotinës	
Komuna e Novacit	
Komuna e Ohrit	
Komuna e Rosomanit	
Komuna e Çeshinovës dhe e Obleshevës	
Komuna e Qendrës	

Komuna e Çuer Sandevës njoftoi se është në proces të themelimit të LSP-së.

## PËRFUNDIMET

Për t'u forcuar sundimi i së drejtës së ligjit, i rëndësisë thelbësore janë reformat në polici si një fushë prioritare për zhvillim të mëtejshëm.<sup>22</sup> Policia, si organi më i dukshëm për ruajtjen e sigurisë publike, i nënshtrohet ndryshimeve që përfshijnë ngritjen dhe rinovimin e mekanizmave për bashkëpunim dhe komunikim të ndërsjellë me qytetarët, të cilët janë një mjet kyç për forcimin e besimit në polici, i cili do të arrijë efektivitet të qëndrueshëm në polici. Koncepti “policia në bashkësi”, pra “polici pranë qytetarëve”, është një filozofi e qasjes ndaj punës policore dhe të kuadrit arsimor, mbi të gjitha për nëpunësit policorë, në drejtim të forcimit të punës policore të parandalimit. Me këtë do të mundësohet bashkëpunim dhe komunikim i ndërsjellë ndërmjet policisë dhe qytetarëve.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve institucionale dhe kuadrit ligjor të punës policore, veçanërisht përmes mekanizmit të “këshillave lokale të parandaluese” (KLP), hulumtimi dhe analiza e kryer tregoi se është e nevojshme të forcohet dhe të promovohet më tej roli i konceptit “policia në bashkësi”, veçanërisht përmes mekanizmave për bashkëpunim me qytetarët, si: këshillat lokale të parandalimit, forumet për diskutime të hapura, funksionimi aktiv i grupeve këshillëdhënëse të qytetarëve (GKQ) dhe rinovimi i shërbimit mbikëqyrës. Kjo do të sigurojë dukshmëri më të madhe të punës policore në shoqëri dhe do të informojë vazhdimisht publikun për zbatueshmërinë e konceptit “policia në bashkësi”. Në këtë mënyrë, qytetarët do të kenë mundësi të njihen më mirë me mënyrën e punës së policisë në bashkësi, sidomos duke pasur parasysh faktin se një përqindje shumë e vogël e tyre e njohin atë.

---

<sup>22</sup> Shilston, Timothy. “Democratic policing, community policing and the fallacy of conflation in international police development missions”, *International Journal of Police Science & Management* 2015, Vol. 17(4), стр. 207–215.



Gjithashtu, këshillat lokale të parandalimit, forumet për diskutime të hapura me qytetarët, si dhe organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, janë një hallkë kyçe në zinxhirin e mekanizmave për punën policore demokratike. Prandaj, për të gjetur zgjidhje për sfidat dhe problemet me të cilat përballen qytetarët në baza ditore, është e nevojshme të rregullohet detyrimi në legjislacionin kombëtar për ngritjen dhe funksionimin aktiv të këshillave lokale parandaluese. Është veçanërisht e rëndësishme që KLP-të ta bëjnë të obligueshme informimin e rregullt të publikut për përbërjen e këshillit, diskutimet e zhvilluara dhe rezultatet e arritura në bashkësitë lokale.

Gjithashtu, është i rëndësishëm rinovimi i shërbimit policor rajonal dhe ai patrullues në territorin e vendit, të përshtatur me kohërat e reja, pasi sipas analizës kërkimore të kryer në këtë projekt, si dhe nëpunësit policorë rajonalë bëjnë një sinergji midis policisë dhe qytetarëve. Me këtë qasje ndaj policisë, policia do të afrohet dukshëm me qytetarët dhe do të forcojë besimin e ndërsjellë, që është veçanërisht e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të punës policore demokratike në shoqëri. Gjithashtu, qasja proaktive e shoqatave civile për realizimin e rregullt të forumeve të hapura për diskutim me qytetarët lidhur me problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, do të mundësojë arritjen e një pune të qëndrueshme dhe efektive policore, bazuar në besimin dhe zbatueshmërinë e konceptit “policia në bashkësi”, gjegjësisht, “policia pranë qytetarëve”.



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



ЕВРОТИНК  
ЦЕНТАР ЗА  
ЕВРОПСКИ СТРАТЕГИИ



CENTER FOR  
EUROPEAN STRATEGIES

EUROTHINK

eurothink.mk

